**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**

**Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve për Periudhën: 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022**

| **Nr. Rendor** | **Data e kërkesës** | **Objekti i kërkesës** | **Data e përgjigjes** | **Përgjigje** | **Mënyra e përfundimit të kërkesës** | **Tarifa** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri Rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve | Data e regjistrimit të kërkesës | Përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi | Data e kthimit të përgjigjes | Përmbajtja e përgjigjes, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi | Përgjigja jepet: E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar | Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik |
| 1. | Kërkesë për infomacion dërguar me Shkresë më datë 07.01.2022 | Kërkesë për informacion nga gazetare e Top Channel, Znj. E.B. në lidhje me dosjen hetimore të shtetasve J.Ç. dhe D.Ç, për vrasjen e kryer në datën 29 Maj 1992, në fshatin Libofshë, Fier. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 10.01.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.81 Prot., datë 07.01.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 01, datë 07.01.2022.Pas shqyrtimit të kërkesës: Ju informojmë se, nga verifikimi i kryer pas kërkesës Tuaj, nuk rezulton të ketë asnjë lloj të dhëne arkivore në lidhje me vendimet dhe dosjet gjyqësore penale dhe civile të viteve 1992 – 1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | është djegur në muajin Janar të vitit 1997. | | |
| 2. | Kërkesë për infomacion dërguar me Shkresë më datë 18.01.2022 | Kërkesë për informacion nga Qendra (…) O.J.F., në lidhje me vendimet gjyqësore të dhëna prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2017 - 31 Dhjetor 2020, që i përkasin veprave penale të parashikuara nga nenet: 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/c, 80, 82, 83 dhe 85 të Kodit Penal, në të cilat viktima të këtyre veprave penale, janë gratë. | Kthim përgjigje me shkresë dhe me<br>E-mail<br>më datë<br>21.01.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.280 Prot., datë 18.01.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 02, datë 18.01.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Vendimin gjyqësor penal me Nr.52303-02135-62-2019 (451) Regj., datë 30.07.2019 Regjistrimi, me Nr. 62-2019-6677 (493) Vendimi, datë 27.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprat penale të parashikuara nga nenet 88/2 dhe 130/a/1 të Kodit Penal. 2. Vendimin gjyqësor penal me Nr.52105-00598-62-2020 (303/11) Regj., datë 09.03.2020/21 Regjistrimi, me Nr. 62-2021-1924 (165) Vendimi, datë 08.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/dh-22 dhe 278/1 të Kodit Penal. 3. Vendimin gjyqësor penal me Nr.52105-00179-62-2019 (177/15) Regj., datë 21.01.2019/20/21 Regjistrimi, me | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr.62-2021-3833 (403) Vendimi, datë 22.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal”. Më lejoni t’Ju sqaroj se, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën 01 Janar 2017 - 31 Dhjetor 2020, janë dhënë vetëm vendimet gjyqësore të sipërcituara, që i përkasin veprave penale të parashikuara nga nenet: 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/c, 80, 82, 83 dhe 85 të Kodit Penal, në të cilat viktima të këtyre veprave penale, janë gratë. Këto vendime gjyqësore të anonimizuara që po Ju vihen në dispozicion janë shkarkuar nga adresa elektronike www.gjykata.gov.al/gjykatafier. Gjithashtu, me vendimin gjyqësor penal nr. 83, datë 21.09.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i pandehuri F.R. eshte deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes për shkak ë marrëdhënieve familjare” në dëm të viktimës L.R. e parashikuar nga neni 79/c i K.Penal dhe është dënuar me 35 vite burgim pas aplikimit të nenit 406 të K.Pr.Penale. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi është lënë në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | fuqi me vendimin nr. 83 dt. 21.09.2017 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë. Ka qenë Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, gjykatë kompetente, që e ka shqyrtuar këtë çështje dhe këtë vendim gjyqësor mund ta tërhiqni pranë kësaj gjykate. *Bashkangjitur këtij e-mail, po Ju vë në dispozicion vendimet gjyqësore të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.* Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar. | | |
| 3. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 19.01.2022 | Kërkesë për informacion nga Z.S.P., në lidhje me një vendim gjyqësor civil të vitit 1993 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me pretendimin se ky informacion/dokum entacion është kërkuar përpara 08 muajsh nga A.SH.K. Drejtoria Vendore Fier dhe nuk i është kthyer përgjigje nga ana e Gjykatës së | Kthim përgjigje me shkresë dhe me E-mail më datë 21.01.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.321 Prot., datë 19.01.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 03, datë 19.01.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Shkresën me Nr.3342/1 Prot., datë 07.06.2021, me lëndë: "*Dërgim informacioni"* të Kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në lidhje me dosjen gjyqësore civile me nr.1803, datë 28.09.1993, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Rrethit Gjyqësor Fier. | | dërguar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Fier”. Më lejoni t’Ju bëj me dije se, Kryesekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ndryshe nga çfarë pretendohet, me shkresën e sipërcituar i ka kthyer përgjigje brenda 05 ditëve shkresës me Nr.4210 Prot., datë 02.06.2021 të paraqitur nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Fier. Gjithashtu, Ju informoj se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nuk rezulton të ketë asnjë lloj të dhëne arkivore në lidhje me vendimet dhe dosjet gjyqësore civile dhe penale të viteve 1992 – 1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është djegur në muajin Janar të vitit 1997. *Bashkangjitur këtij e-maili, po Ju vë në dispozicion shkresën Nr.3342/1 Prot., datë 07.06.2021 të Kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.* | | |
| 4. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 21.01.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.F.Z, si përfaqësuese me prokurë e palës paditëse M.B, në lidhje me planifikimin e | Kthim përgjigje me E-mail më datë 21.01.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.364 Prot., datë 21.01.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | seancës për çështjen civile që i përket palës paditëse: M.B. dhe palë e paditur: E.B., me objekt: “*Zgjidhje martese*” e cila po shqyrtohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | numër rendor 04, datë 21.01.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Skedulin e çështjes me Nr.21001-03154-62-2021, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)”. Ju njoftoj se seanca e parë e veprimeve të pajtimit për çështjen civile që i përket palës paditëse: M.B. dhe palë e paditur: E.B., me objekt: “*Zgjidhje martese*” është planifikuar të zhvillohet në datën 10.02.2022, ora 15:00, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtaren (….). | | |
| 5. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 26.01.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.S.N., si përfaqësues me prokurë të posacme i viktimës O.H., në lidhje me ecurinë e seancës gjyqësore të datës 25.01.2022, si dhe planifikimin e seancës së ardhshme gjyqësore që i përket çështjes penale në ngarkim të të pandehurit R.H., e cila po shqyrtohet | Kthim përgjigje me E-mail më datë 26.01.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.429 Prot., datë 26.01.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 05, datë 26.01.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Skedulin e çështjes penale me Nr.58344-01967-62-2021, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju njoftoj se, seanca gjyqësore e datës 25/01/2022, ora 12:00, është shtyrë për shkak të mos paraqitjes së prokurorit (….) për arsye shëndetësore. Bëj me dije se, seanca e ardhshme gjyqësore për çështjen penale që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurit: (….), është planifikuar të zhvillohet në datën 10/02/2022, ora 13:30, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtaren Znj. (….). | | |
| 6. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 02.02.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga qytetari Z.I.H. në cilësinë e palës paditëse, në lidhje me aktet gjyqësore të çështjes civile, me objekt: *"Lëshimin e urdhërit të mbrojtjes"* të shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 03.02.2022 | Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë Tuaj, Ju bëjmë me dije se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", është administruar kërkesa e qytetarit z. Ilir Hilaj, me lëndë "*Detyrim dërgim të akteve gjyqësore*" me nr.614 Prot., datë 02.02.2022, për dhënie informacioni/dokumentacioni, rregjistruar me numër rendor 06, datë 02.02.2022. Në kushtet kur, informacioni/dokumentacioni i kërkuar nga qytetari Z (….), nuk disponohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ndaj vendimit gjyqësor me nr.62-2021-4454 | E deleguar | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | (181), datë 23.09.2021, është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit "Për të drejtën e Informimit", Ju dërgojmë për kompetencë dhe trajtim shkresën me nr.614 Prot., datë 02.02.2022. Ju informojmë se nga komunikimi me K/Sekretaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier bëhet me dije që, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier disponohet vetëm vendimi gjyqësor i Gjykatës së Apelit Vlorë, ndërsa praktika e plotë gjyqësore në të cilën ndodhen aktet shkresore të kërkuara nga z. (….) ndodhen në Gjykatën e Apelit Vlorë. Bashkëngjitur gjeni: 1. Vendimin gjyqësor dhe RIV (Regjistrin e Veprimeve) për çështjen civile me nr. 62-2021-4454 (181), datë 23.09.2021, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). Ju lutemi që informacioni/dokumentacioni i kërkuar t'i dërgohet drejtpërdrejtë kërkuesit. | | |
| 7. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail | Kërkesë për informacion nga Av. Y. K., si ish mbrojtës i të dënuarit A.H., në | Kthim përgjigje me shkresë më datë 03.02.2022 | N Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | më datë 03.02.2022 | lidhje me ecurinë e gjykimit, datën dhe orën e seancës për kërkesën penale me objekt: “*Bashkim dënimesh*” që po shqyrtohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.617 Prot., datë 03.02.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 07, datë 03.02.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Vendime gjyqësore (05 copë) që i përkasin të dënuarit Aldison Haxhiaj, me objekt: “Bashkim dënimesh”, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). Ju informoj se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk ka në shqyrtim asnjë çështje gjyqësore që i përket të dënuarit Aldison Haxhiaj, me objekt: “Bashkim dënimesh”. | | |
| 8. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 03.02.2022 | Kërkesë për informacion nga Av. B.M., si përfaqësues i palës paditëse M.B. dhe E.B., nëse ka ardhur dosja civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nga Gjykata e Apelit Vlorë, me objekt: *“Shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror”* që i përket | Kthim përgjigje me shkresë më datë 03.02.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.636 Prot., datë 03.02.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 08, datë 03.02.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se, nga komunikimi me K/Sekretaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bëhet me dije që dosja gjyqësore | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | palëve paditëse: M.B. dhe E.B. | | civile që i përket palëve paditëse: M.B., E.B., me objekt: “*Shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror*”, nuk ka ardhur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nga Gjykata e Apelit Vlorë. | | |
| 9. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 10.02.2022 | Kërkesë për informacion nga Znj.E.V., në cilësinë e palës së paditur, për ecurinë e çështjes civile me objekt: “*Zgjidhje martese*”, e cila po shqyrtohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pasi për arsye shëndetësore e ka të pamundur të paraqitet në gjykim. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 11.02.2022. | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.804 Prot., datë 10.02.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 09, datë 10.02.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1.Procesverbalin e seancës së veprimeve të pajtimit të datës 10.02.2022, që i përket çështjes civile me Nr.21001- (….) -62-2021 Regjistri, datë 15.09.2021 Regjistrimi, që i përket palës paditëse: K.V. dhe palë e paditur: E.V. (J.) me objekt: “*Zgjidhje martese*”, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 2. Skedulin e çështjes civile me Nr.21001- (….) -62-2021 Regjistri, datë 15.09.2021 Regjistrimi, që i përket palës paditëse: (….) dhe palë e paditur: (….), me objekt: | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | "*Zgjidhje martese*", të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju bëj me dije se, tek "Procesverbali" do të gjeni arsyen se përse është shtyrë seanca e datës 10.02.2022, ndërsa tek "Skeduli i çështjes" do të gjeni planifikimin e seancës së ardhshme. Seanca e ardhshme e veprimeve të pajtimit është caktuar në datën 10.03.2022, ora (….). | | |
| 10. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 15.02.2022 | Kërkesë për informacion nga Z.I.D., si përfaqësues i palës së paditur M.B.Zh.R, në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës për çështjen civile me objekt: "*Pavlefshmëri Kontrate*", e cila është shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 15.02.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.895 Prot., datë 15.02.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 10, datë 15.02.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Dispozitivin për seancën gjyqësore të datës 15.02.2022, që i përket çështjes civile me Nr. (….)-62-2021 Regjistri, datë 22/10/2021 Regjistrimi, që i përket palës paditëse: Shoqëria "(….)" sh.p.k., palë e paditur: M.B.Zh.R. dhe subjekt i interesuar: Avokatura e Shtetit, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Zyra Vendore Vlorë, me objekt: *"Pavlefshmeri Konrate"*, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju bëj me dije se, në përfundimit të gjykimit, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarja Znj. (….) ka vendosur: "Pranimin e kërkesë-padisë" (….). | | |
| 11. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 15.02.2022 | Kërkesë për informacion nga gazetari i Tv Klan, Z.S.K., në lidhje me vendimin e dënimit të shtetasit L.M., që janë dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 15.02.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.899 Prot., datë 15.02.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 11, datë 15.02.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se nga verifikimi i kryer, nuk rezulton të ketë asnjë vendim dënimi për kryerjen e ndonjë vepre penale nga ana e shtetasit L.M. pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | E plotë | Falas |
| 12. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 16.02.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.S.V, si përfaqësues me prokurë i shtetasit të arrestuar O.J., në lidhje me planifikimin e | Kthim përgjigje me E-mail më datë 16.02.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.900 Prot., datë 16.02.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | seancës që i përket kërkesës penale, me objekt: "*Vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit*" ndaj shtetasit të arrestuar O.J, e cila do të shqyrtohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | numër rendor 12, datë 16.02.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Informacion mbi çështjen dhe skedulin e kërkesës penale me Nr. 60610-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju njoftoj se seanca gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës penale që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: "*Vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit*" ndaj shtetasit të arrestuar O.J., është planifikuar të zhvillohet në datën (….).02.2022, ora 10:30, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtarin (….). | | |
| 13. | Kërkesë për infomacion dërguar me Shkresë më datë 17.02.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion, nga përfaqësuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Znj.E.S. në lidhje me: - Numrin e çështjeve gjyqësore civile dhe/ose penale që janë në proces, që janë | Kthim përgjigje me shkresë më datë 18.02.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.930 Prot., datë 17.02.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 13, datë 17.02.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pushuar, pezulluar, apo përfunduar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me palë gazetar, apo punonjës të medias.<br>- Numrin e çështjeve gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me palë gazetar, apo punonjës të medias lidhur me veprat penale të "Shpifjes" dhe "Fyerjes", si dhe disponimin e vendimit të gjykatës;<br>- Numrin e vendimeve civile dhe penale të marra nga gjykata, si dhe kopje të vendimeve të anonimizuara për çështet civile me objekt: "Marrëdhënie pune". Informacioni këkerkohet për periudhën Janar – Dhjetor 2021. | | përgjigjet e pyetjeve Tuaja, si më poshtë vijon: "1. Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është aktualisht në gjykim vetëm 01 (një) çështje gjyqësore "kundravajtje penale", me palë gazetar/punonjës i medias. 2. Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka asnjë çështje gjyqësore civile/penale të pushuar me palë gazetar, apo punonjës i medias. 3. Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka asnjë çështje gjyqësore civile/penale të pezulluar me palë gazetar, apo punonjës i medias. 4. Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është aktualisht në gjykim vetëm 01 (një) çështje gjyqësore me nr.(….)-62-2021 Regj.Them., datë (….)/2021 Regjistrimi, shortuar në datën 07/09/2021, e cila është kundravajtje penale me objekt: "Fyerja" të parashikuar nga Neni 119 Kodit Penal, me palë: (….) [I Dëmtuari Akuzues] dhe (….) [I Dëmtuari Akuzues], kundër (….) [I Akuzuari], ku të dëmtuarit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | akuzues janë gazetar/punonjës të medias. Bashkangjitur po Ju dërgojmë: "Informacion mbi çështjen" të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 5. Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë dhënë 02 (dy) vendime gjyqësore, një për çështje penale dhe një për çështje civile. Ju bëj me dije se vendimi gjyqësor penal nuk ka të bëjë drejtëpërdrejtë me profesionin, por i pandehuri është gazetar/punonjës i medias. Bashkangjitur po Ju dërgojmë: Vendimin gjyqësor penal me Nr. (….)-62-2021 (….) Regjistri Themeltar, datë (….)/2021 Regjistrimi, Nr.62-2021-(….) (….) Vendimi, datë (….)/2021 Vendimi, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me palë kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurit: (….), akuzuar: *"Për kryerjen e veprës penale të "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal*, të nxjerrë nga portali elektronik www.gjykata.gov.al., i anonimizuar. 6. Për periudhën | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Janar – Dhjetor 2021 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka përfunduar vetëm 01 (një) çështje civile me palë paditës gazetar/punonjës i medias, me objekt: "Marrëdhenie pune". Bashkangjitur po Ju dërgojmë: "Vendimin gjyqësor civil me Nr. (….)-62-2020 (….) Regjistri Themeltar, datë (….)/2021 Regjistrimi, Nr.62-2021-(….)Vendimi, datë (….)/2021 Vendimi, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me palë paditëse: (….), me palë të paditur: Shoqëria "(….)", me objekt: "*Konstatimin e detyrimit ligjor të pagesës së kontributeve shoqërore dhe shëndetësore nga ana e të padituri ndaj paditësit, për periudhën prej 2008-2015*", të nxjerrë nga portali elektronik www.gjykata.gov.al., i anonimizuar". Më lejoni t'Ju sqaroj se informacioni i kërkuar prej Jush i mbështetur në ***"profesion",*** nuk gjenerohet nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) me të cilin pasqyrohet veprimtaria e punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, por u sigurua në rrugë informale, duke pyetur çdo gjyqtar që ushtron | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | |
| 14. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 06.03.2022 | Kërkesë për informacion nga z.A.Sh. (shtetas kosovar), si palë kërkuese, në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës për kërkesën civile, me objekt: "*Kërkesë për ndihmë juridike dytësore*" e cila është shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 07.03.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1419 Prot., datë 07.03.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 14, datë 07.03.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Vendimin gjyqësor Nr. 62-2022-(….), datë (….)/02/2022, që i përket çështjes civile me Nr. 90915-(….)-62-2022 (….) Regjistri, datë (….)/02/2022 Regjistrimi, që i përket palës kërkuese: A.Sh., me objekt: *"Kërkesë për ndihmë juridike dytësore*", të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju bëj me dije se, në përfundimit të gjykimit, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari z. (….) ka vendosur: *"Rrëzimin e kërkesës"* dhe shkaqet së përse është rrëzuar kërkesa Juaj për ndihmë juridike dytësore i keni të arsyetuara në vendim. | E plotë | Falas |
| 15. | Kërkesë për infomacion | Kërkesë për informacion nga | Kthim përgjigje me | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dërguar me E-mail më datë 15.03.2022 | Znj.A.H. e Studios Ligjore (….), si përfaqësuese ligjore e të pandehurit H.K., në lidhje me caktimin e seancës së ardhshme gjyqësore, duke qenë se për seancën gjyqësore të datës 10.03.2022 ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance. | E-mail më datë 15.03.2022 | Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1566 Prot., datë 15.03.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 15, datë 15.03.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga gjyqtarja që ka në shqyrtim çështjen, gjyqtarja (….), bashkëngjitur gjeni: "1. Skedulin e çështjes që i përket çështjes penale me palë kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurit H.K., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "*Dhunës në familje*", të parashikuar nga neni 130/a/4 të Kodit Penal, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Bëj me dije se, seanca e ardhshme gjyqësore është planifikuar të zhvillohet në datën (….).03.2022, ora (….). | | |
| 16. | Kërkesë për infomacion dërguar me Shkresë më datë 17.03.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion, nga përfaqësuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Znj.E.S. në | Kthim përgjigje me shkresë dhe me e-mail më datë 25.03.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lidhje me: - Numrin e çështjeve gjyqësore penale që janë regjistruar, apo që janë përfunduar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në zbatim të neneve 89/b dhe 242/a të Kodit Penal, si dhe të dhëna statistikore mbi numrin e vendimeve dhe dënueshmërinë e shtetasve të pandehur për këto vepra, gjatë të njëjtës periudhë. | | nr.1656 Prot., datë 17.03.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 16, datë 17.03.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: “1. Për periudhën Maj 2020 - Mars 2022, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka patur asnjë çështje gjyqësore penale të regjistruar në zbatim të neneve 89/b dhe 242/a të Kodit Penal. Për rrjedhojë, nuk ka as edhe një vendim gjyqësor penal të dhënë ndaj shtetasve të pandehur, të akuzuar për veprat penale: “*Përhapja e sëmundjeve infektive*” dhe “*Moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë*”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 89/b dhe 242/a të Kodit Penal. 2. Duke qenë se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën Maj 2020 - Mars 2022, nuk ka patur asnjë çështje gjyqësore penale të regjistruar, apo të përfunduar në zbatim të neneve 89/b dhe 242/a të Kodit Penal, bëjmë me dije se nuk disponojmë asnjë vendim dënimi, apo të dhëna statistikore mbi dënueshmërinë e shtetasve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pandehur për veprat penale të sipërcituara”. | | |
| 17. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 18.03.2022 | Kërkesë për informacion nga Znj.K.B. e (….) sh.p.k., si trajtues dëmesh e kontraktuar nga shoqëria e sigurimeve (….), në lidhje me ecurinë e një vendimi gjyqësor penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nëse ka marrë, apo jo formë të prerë. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 25.03.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.1692 Prot., datë 18.03.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 17, datë 18.03.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: “Nga komunikimi me K/Sekretaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bëhet me dije që dosja gjyqësore penale është përcjellë me shkresën Nr.442 Regj., datë 17.11.2020, në Gjykatën e Apelit Vlorë, pasi ndaj vendimit gjyqësor penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me Nr.62-2020-(….), datë Vendimi (….).10.2020, që i përket palëve kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: “*Gjykimi i të pandehurit* (….), *akuzuar për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga nenet 290/2, 291, 273 dhe 242 të Kodit Penal*” ka patur ankim. Dosja aktualisht ndodhet në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe vendimi nuk ka marrë formë të prerë”. | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 23.03.2022 | Kërkesë për informacion nga Z.N.L. me profesion inxhiner nafte, aktualisht pensionist, në kuadër të një angazhimi profesional me disa kolegë të tij, për njohjen dhe përshkrimin e historisë së naftës, kërkon të lexojë dosjet gjyqësore të gjeologëve të naftës të vitit 1976 dhe të vitit 1980, të gjykuara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 25.03.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1742 Prot., datë 23.03.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 18, datë 23.03.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës: "Ju informojmë se, nga verifikimi i kryer pas kërkesës Tuaj, nuk rezulton të ketë asnjë lloj të dhëne arkivore në lidhje me vendimet dhe dosjet gjyqësore penale dhe civile të viteve 1976 dhe 1980 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është djegur në muajin Janar të vitit 1997". | E plotë | Falas |
| 19. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 01.04.2022 | Kërkesë për informacion nga Znj.D.M., në kuadër të një projekti të Lëvizjes MJAFT, në plotësimin e një pyetësori për të vlerësuar hapjen institucionale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në kërkimin online të faqes zyrtare të | Kthim përgjigje me E-mail më datë 04.04.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1950 Prot., datë 01.04.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 19, datë 01.04.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Linkun me informacionin zyrtar të plotësuar për Gjykatën e Rrethit | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjykatës me informacion zyrtar. | | Gjyqësor Fier, në kuadër të projektit "*Accountability, Technology and Institutional Openness in Albania – ActionALBANIA*". | | |
| 20. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 04.04.2022 | Kërkesë për infomacion nga Znj.A.P., në lidhje me tërheqjen e akteve shkresore të dosjeve civile në të cilat kjo shtetase ka qenë palë në gjykim nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, me pretendim se nuk i janë vënë në dispozicion në formën e duhur ligjore. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 04.04.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1955 Prot., datë 04.04.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 20, datë 04.04.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës Ju informojmë se, nga komunikimi me Arkivisten e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, më bëhet me dije që dosjet gjyqësore civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe më konkretisht: "1. Dosja gjyqësore civile Nr. 62-2015-(….) vendimi, datë 27/05/2015 vendimi, që i përket palës paditëse: (….), palë e paditur: (….), me objekt: "*Zgjidhje martese, etj.*"; 2. Dosja gjyqësore civile Nr. 62-2020-(….) vendimi, datë 26/02/2020 vendimi, që i përket palës paditëse: (….), palë e paditur: (….), me objekt: "*Zgjidhje martese, etj.*", e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; si dhe; 3. Dosja gjyqësore civile Nr. 62- | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2020-(….) vendimi, datë 12/10/2020 vendimi, që i përket palës kërkuese: (….) dhe person i tretë: (….), me objekt: "*Ndreqje gabimi material në vendimin gjyqësor*", janë të fotokopjuara dhe Ju mund të paraqiteni për t'i tërhequr ato që ditën e nesërme pranë Zyrës së Arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, menjëherë sapo të paraqisni mandatin e pagesës sipas ligjit. Gjithashtu më lejoni t'Ju sqaroj se, duke qenë se nuk kisha dijeni më parë për kërkesën Tuaj, i dërgova e-mail zyrtar kolegeve të mia, për të marrë informacionin e kërkuar nga ana Juaj dhe zgjidhjen e situatës. Për këtë fakt, Ju vura në dijeni si palë kërkuese. | | |
| 21. | Shkresë më datë 26.04.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale Fier, në lidhje me çështjet gjyqësore civile që janë aktualisht duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: "Zgjidhje martese". | Kthim përgjigje me shkresë më datë 26.04.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.2446 Prot., datë 26.04.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 21, datë 26.04.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Listën e personave që rezultojnë të jenë në proces gjyqësor civil me | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | objekt: "*Zgjidhje martese*" pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier". | | |
| 22. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 12.05.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.E.Gj., si përfaqësuese e palës paditëse Shoqëria (….), në lidhje me zhvillimin e seancës gjyqësore. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 12.05.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.2758 Prot., datë 12.05.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 22, datë 12.05.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informoj se gjyqtarja znj. (….) është paraqitur ditën e sotme në punë dhe është duke zhvilluar gjykimet normalisht. Përsa i përket çështjes që Ju përfaqësoni, do të merrni njoftim nga ana e sekretares gjyqësore që asiston gjyqtaren (….). | E plotë | Falas |
| 23. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 13.05.2022 | Kërkesë për informacion nga Shoqëria (….), në lidhje me tre kërkesa me objekt: "*Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit*" të depozitura pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 16.05.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.2815 Prot., datë 13.05.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 23, datë 13.05.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: Informacionin/dokumentacionin që i përket kërkesave civile të depozituara pranë Gjykatës së | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Rrethit Gjyqësor Fier në datën 27.01.2022, me palë kërkuese/kreditor: Shoqëria “(….)” sh.p.k.; kundër debitorëve: (….), (….) dhe (….), me objekt: “*Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit*”, të cilat kanë përfunduar me: “Pranimin e kërkesës”. | | |
| 24. | Shkresë më datë 19.05.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Avokati i Popullit, në lidhje me gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit (….), e cila është aktualisht duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 23.05.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.2904 Prot., datë 19.05.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 24, datë 19.05.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion mbi çështjen penale me Nr.(….)-62-2021 Regjistri, datë (….).2021 Regjistrimi, që i përket palës kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurit: (….), të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 2. Skedulin e çështjes penale me Nr.(….)-62-2021 Regjistri, datë (….).2021 Regjistrimi, që i përket palës kërkuese: Prokuroria e Rrethit | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjyqësor Fier, kundër të pandehurit: (….), të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). Më lejoni t'Ju sqaroj se, çështja penale në ngarkim të të pandehurit (….) është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën (….).2021. Po në datën (….).2021 kjo çështje është shortuar dhe i ka rënë për gjykim gjyqtares znj. (….). Kjo çështje po shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Kryesuese seance është gjyqtarja znj. (….) dhe anëtarët janë gjyqtarët: znj. (….) dhe znj. (….). Kjo çështje po shqyrtohet me gjykim të zakonshëm dhe jo me gjykim të shkurtuar. Tek dokumenti "Skeduli i çështjes" do të gjeni planifikimin e të gjitha seancave gjyqësore. Janë zhvilluar gjithsej 20 seanca gjyqësore. Jepet informacion i detajuar mbi të gjitha seancat gjyqësore". Seanca e ardhshme gjyqësore "Për shpalljen e vendimit përfundimtar" është caktuar për tu zhvilluar në datën (….).2022, ora (….). Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar. | | |
| 25. | Shkresë më datë 27.05.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga KLGJ, në lidhje me numrin e kërkesave të paraqitura nga aplikantët përmes shërbimit online: “Formulari elektronik i aplikimit” në portalin www.gjykata.gov.al/gjykatafier. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 31.05.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.3091 Prot., datë 27.05.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 25, datë 27.05.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk është paraqitur asnjë kërkesë përmes shërbimit online: *“Formulari elektronik i aplikimit”* në portalin www.gjykata.gov.al/gjykatafier. Ndodhur në këto kushte, nuk ka asnjë kërkesë të trajtuar, apo të patrajtuar. Gjithashtu, më lejoni t’Ju bëj me dije se shërbimi i Kryesekretarisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ofrohet gjatë gjithë orarit zyrtar të punës $08^{00}$-$16^{00}$ dhe qytetarët pajisen në kohë reale me dokumentat që kërkojnë. Më lejoni t’Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar. | E plotë | Falas |
| 26. | Kërkesë për infomacion | Kërkesë për informacion nga | Kthim përgjigje me | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dërguar me E-mail më datë 31.05.2022 | Z.F.M. në cilësinë e viktimës, në lidhje me ecurinë e një vendimi gjyqësor penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nëse ndaj këtij vendimi është depozituar ankim nga ana e të pandehurve. | E-mail më datë 31.05.2022 | Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.3166 Prot., datë 31.05.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 26, datë 31.05.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: "Nga komunikimi me K/Sekretarenë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier bëhet me dije se ndaj vendimit gjyqësor penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me Nr. 62-2022-(….), datë Vendimi (….)/2022, që i përket palëve kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, viktimë: F.M., kundër të pandehurve: (….) dhe (….), akuzuar: "*Për kryerjen e veprës penale "Plagosje e lehtë me dashje" në bashkëpunim parashikuar nga 89-25 i Kodit Penal*" deri ditën e sotme është paraqitur ankim nga ana e Prokurorisë". | | |
| 27. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 07.06.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.M.Q., si përfaqësues i palës paditëse (….), në lidhje me ecurinë e një kërkesë-padie të depozituar në | Kthim përgjigje me E-mail më datë 07.06.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.3347 Prot., datë 07.06.2022, për dhënie informacioni, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, nëpërmjet shërbimit postar. | | rregjistruar me numër rendor 27, datë 07.06.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: 1. Informacion dhe skedulin e çështjes me Nr. 21001-01444-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju bëj me dije se nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), rezulton se cështja civile që i përket palës paditëse: (….) dhe palë e paditur: (….), me objekt: "*Zgjidhje martese*" është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën 30/05/2022. Kjo çështje është shortuar në datën 31/05/2022 dhe i ka rënë për shqyrtim gjyqtares znj. (….). Seanca e parë e veprimeve të pajtimit për këtë çështje civile është planifikuar të zhvillohet në datën (….).2022, ora 14:15, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtaren (….). | | |
| 28. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 13.06.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion, nga Znj.D.K., Gazetare në MCN TV, në lidhje me çështjet | Kthim përgjigje me E-mail më datë 16.06.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjyqësore penale që lidhen me “cannabis sativa” në zbatim të neneve 283-284 të K.Penal, të cilat janë përfunduar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2014 – 31 Mars 2022, si dhe të dhëna statistikore mbi masat e sigurimit “arrest në burg” për veprat e sipërcituara, gjatë së njëjtës periudhë. | | nr.3479 Prot., datë 13.06.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 28, datë 13.06.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore penale *që janë përfunduar* pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2014, deri në 03-Mujorin e Parë për vitin 2022. Në këto tabela do të gjeni çështje penale themeli të gjykuara gjithsej dhe të kategorizura sipas dispozitave ligjore të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë *(Neni 283 i K.Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” – Neni 284 i K.Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”, si dhe paragrafët e tyre)*”. Bashkangjitur këtij e-maili po Ju dërgojmë: “Tabelat me të dhënat statistikore për vitet: 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 3-Mujorin e Parë të vitit 2022”, për të gjitha çështjet gjyqësore penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku do t’i gjeni të ndara sipas dispozitave ligjore (Neni përkatës) për çështjet penale. (Sqaroj se për Vitet 2014 – 2018, në kolonën G - K jepen të dhënat për çështjet | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | penale të përfunduara dhe të dhëna në lidhje me *vendimmarrjen e gjykatës*, ndërsa në kolonën Y janë masat e sigurimit *“arrest në burg”* dhe në vijim të tabelës janë masa të tjera sigurimi. Për Vitet 2019 – 3 Mujori i Parë 2022, në kolonën H - L jepen të dhënat për çështjet penale të përfunduara dhe të dhëna në lidhje me *vendimmarrjen e gjykatës*, ndërsa në kolonën Z janë masat e sigurimit *“arrest në burg”* dhe në vijim të tabelës janë masa të tjera sigurimi). *Statistikat që po Ju vihen në dispozicion, janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.* Për çdo paqartësi që mund të hasni, mos hezitoni të na kontaktoni. | | |
| 29. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 14.06.2022 | Kërkesë për informacion nga Znj.A.K., që nuk është palë në gjykim, në lidhje me një vendim gjyqësor që është dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vendim i cili është ankimuar. | Kthim përgjigje me E-mail dhe me shkresë më datë 15.06.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.3504 Prot., datë 14.06.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 29, datë 14.06.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: “Nga komunikimi me K/Sekretaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bëhet me dije që dosja gjyqësore civile është përcjellë me shkresën Nr.923 Regj., datë 09.12.2020, në Gjykatën e Apelit Vlorë, pasi ndaj vendimit gjyqësor civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me Nr.62-2020-(….), datë Vendimi (….).2020, që i përket palëve paditëse: (….); me palë të paditura: Shoqëria " (….)" sh.a. dhe Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë; person i tretë: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë, me objekt: "*Konstatimin e faktit të diskriminimit... Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror...etj.*" ka patur ankim. Dosja civile aktualisht ndodhet në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe vendimi nuk ka marrë formë të prerë. (bashkangjitur po Ju vëmë në dispozicion shkresën përcjellëse të sipërcituar). Përsa i përket informacionit/dokumentacionit të kërkuar, nga verifikimet e kryera rezulton se: "*Ju nuk jeni palë në këtë gjykim, nuk jeni as përfaqësues i palëve në gjykim dhe as nuk i keni paraqitur gjykatës bashkangjitur kërkesës, interesin Tuaj të ligjshëm për marrjen e këtij vendimi, apo pëlqimin e subjektit të të* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *dhënave”.* Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Nenin 15, pika 1 dhe 2 të saj, përcakton qartë se: *“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*. Në Nenin 35, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet detyrimi që: *“Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj”.* Gjithashtu, më lejoni t’Ju bëj me dije se ky vendim gjyqësor përmban: *“Të dhëna personale dhe të dhëna sensitive”* në përputhje me nenin 2, me nenin 3 pika “1” dhe “2”, si dhe në nenin 5 të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor. Referuar nenit 17, pika 1, gërma | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | "a" të Ligjit nr.119/2014, "*Për të drejtën e Informimit*", përcaktohet se e drejta për informim mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: *"të drejtën për një jetë private"*. Kjo e drejtë nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës, ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Për më tepër, konstatojmë se palë në këtë gjykim civil janë edhe pesë fëmijë të mitur. Vendimi gjyqësor civil përmban të dhëna që mbrohen nga ligji Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës". Në nenin 29 të ligjit të sipërcituar sanksionohet detyrimi që: "*Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike".* Mbështetur edhe në Urdhërin nr. 6777/5, datë 30.09.2010 "*Për miratimin e Rregullores për marrëdhënien e Gjykatës me Publikun*", të Ministri të Drejtësisë, kreu I, pika 2 gërma | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | "f" dhe pika 3 gërma "a" dhe "ç"; kreu VI, pika 5.1 dhe pika 5.9 në listën e dokumenteve *me akses të kufizuar* përfshihen: "Të dhënat personale të çdo personi, sipas kuptimit që jep ligji për mbrojtjen e të dhënave personale" (pika 5.1). Vendimi gjyqësor përmban të dhëna në përputhje me nenin 2, me nenin 3 pika "1" dhe nenin 5 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Vendimet gjyqësore të anonimizuara mund t'i gjeni në portalinwww.gjykata.gov.al/gjykatafier.Për të gjitha arsyet e sipërcituara, në respektim të privatësisë së palëve në proces, bazuar edhe në Urdhërin nr. 6777/5, datë 30.09.2010 "*Për miratimin e Rregullores për marrëdhënien e Gjykatës me Publikun*" kreu VI, pika 4.1, vlerësojmë se informacioni/dokumentacioni i kërkuar është i mbrojtur nga ligjet në fuqi dhe nuk mund t'Ju vihet në dispozicion nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | |
| 30. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail | Kërkesë për informacion nga Av.N.M, në lidhje me procedurën që | Kthim përgjigje me E-mail më datë | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | më datë 14.06.2022 | duhet të ndjekë për të tërhequr vendimin dhe një kopje të dosjes civile të gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në vitin 1994. | 15.06.2022 | nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.3503 Prot., datë 14.06.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 30, datë 14.06.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës: "Ju informojmë se, nga verifikimi i kryer pas kërkesës Tuaj, nuk rezulton të ketë asnjë lloj e dhëne tjetër arkivore, ***përveç vendimit gjyqësor,*** në lidhje me dosjet gjyqësore civile të vitit 1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është djegur në muajin Janar të vitit 1997". Gjithashtu, më lejoni t'Ju bëj me dije se vendimin gjyqësor civil të vitit 1994, mund ta tërhiqni duke u paraqitur pranë sportelit të Kryesekretarisë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shërbim i cili ofrohet çdo ditë të javës nga e hëna – në të premten, gjatë orarit zyrtar të punës $08^{00}$ - $16^{00}$, përkundrejt tarifës së përcaktuar për tërheqjen e vendimit gjyqësor, ose përmes shërbimit online: *"Formulari elektronik i aplikimit"* në portalin www.gjykata.gov.al/gjykatafier. Përmes portalit elektronik e-Albania mund të tërhiqen vetëm dosjet gjyqësore dhe fashikujt | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | hetimorë që ndodhen pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor Lundër, Tiranë. | | |
| 31. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 24.06.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.A.M., si përfaqësues i palës paditëse F.Xh., në lidhje me planifikimin e seancës që i përket çështjes civile, me objekt: "*Zgjidhje martese*", e cila është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe është planifikuar ndonjë shtyrje seance nga ana e gjyqtares. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 24.06.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.3775 Prot., datë 24.06.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 31, datë 24.06.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Skedulin e çështjes civile me Nr. 21001-00961-62-2022 akti, që i përket palës paditëse: F.Xh. dhe palë e paditur: H.Xh., me objekt: "*Zgjidhje martese*", të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Seanca është planifikuar të zhvillohet **në datën** (….)**.06.2022, ora** (….)**,** pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtaren (….). Gjithashtu, Ju bëj me dije se nuk është planifikuar ndonjë shtyrje seance për shkak te mosparaqitjes në punë të gjyqtares së çështjes. | E plotë | Falas |
| 32. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail | Kërkesë për informacion nga Z.R.B., ku kërkon nga | Kthim përgjigje me E-mail | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | më datë 29.06.2022 | gjykata të drejtën për dëmshpërblim, pasi një kompani private i ka shkaktuar dëm në pronën e tij. | më datë 04.07.2022 | përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.3967 Prot., datë 29.06.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 32, datë 04.07.2022. Më lejoni t'Ju informoj se, kërkesa Juaj nuk është në përputhje me dispozitat procedurale të parashikuara në nenet 154, 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile. Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Penale përcaktojnë rregulla të hollësishme për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, personat juridikë dhe shtetasit. Në rast se | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ju dëshironi të denonconi një vepër penale, atëherë Ju mund të drejtoheni në çdo komisariat policor, pasi organet hetuese janë Policia dhe Prokuroria. | | |
| 33. | Shkresë më datë 29.06.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale Fier, në lidhje me çështjet gjyqësore civile që janë aktualisht duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: "Zgjidhje martese". | Kthim përgjigje me shkresë më datë 04.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.3850 Prot., datë 29.06.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 33, datë 04.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Listën e personave që rezultojnë të jenë në proces gjyqësor civil me objekt: "*Zgjidhje martese*" pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier". | E plotë | Falas |
| 34. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 06.07.2022 | Kërkesë për informacion nga Z.E.M., në cilësinë e palës paditëse për mënyrën se si mund të pajiset me një vërtetim me të dhëna të detajuara në lidhje me një çështje që është në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe se si mund të pajiset | Kthim përgjigje me<br>E-mail<br>më datë<br>06.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.4010 Prot., datë 06.07.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 34, datë 06.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion mbi çështjen dhe Skedulin e çështjes me Nr. 21001-(….)-62-2022, të nxjerrë nga | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me një vendim gjyqësor për një çështje që është pushuar pranë kësaj gjykate. | | Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 2. Lista e tarifave dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykata”. Ju informoj se tek dokumenti “Informacion mbi çështjen” do të gjeni datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë dhe objektin e kërkesë-padisë. Kjo çështje është regjistruar në datën 19/07/2021. Tek “Skeduli i çështjes” do të gjeni planifikimin e të gjitha seancave. Ju mund të tërhiqni në çdo kohë pranë Kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nga dita e Hënë në të Premten, nga ora 08:00 – 16:00, vërtetim që kjo çështje është në gjykim, si dhe vendimin gjyqësor për çështjen e pushuar, nëpërmjet avokatit/es, apo nëpërmjet ndonjë të afërmi Tuaj. Tarifat gjyqësore për tërheqjen e vendimit dhe tërheqjen e vërtetimit është 200 lekë për secilën. Gjithashtu, Ju bëj me dije se seanca e ardhshme për çështjen civile që i përket palës paditëse: E.M. dhe palë e paditur: (….), me objekt: “*Zgjidhje martese*” është planifikuar të zhvillohet në datën (….).07.2022, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ora (….), pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtaren (….). | | |
| 35. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 06.07.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.K.K.., si përfaqësuese e palës së paditur (….), nëse e ka pranuar, apo jo gjykata një kërkesë për shtyrje seance të paraqitur nga ana e tyre. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 06.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.4026 Prot., datë 06.07.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 35, datë 06.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Skedulin e çështjes civile me Nr. 21234-(….)-62-2022 akti, që i përket palës paditëse: T.K., etj.; palë e paditur: (….), me objekt: "*Shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror*", të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju informoj se, seanca gjyqësore e datës 04.07.2022 është shtyrë pasi gjykata ka marrë në konsideratë faktin e bojkotit të seancave nga ana e avokatëve. Seanca e ardhshme gjyqësore është planifikuar të zhvillohet në datën (….).10.2022, ora (….), pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtaren znj. (….). | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 36. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 08.07.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.A.C., si përfaqësues i palës kërkuese B.T., në lidhje me ecurinë e një kërkese penale, me objekt: "*Rivendosje në afat*", të cilën e ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nëpërmjet shërbimit postar. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 08.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.4074 Prot., datë 08.07.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 36, datë 08.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion mbi çështjen me Nr.70102-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 2. RIV (Regjistri i Veprimeve) të çështjes me Nr.70102-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 3. Skedulin e çështjes me Nr.70102-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS) ". Ju informoj se, tek dokumentet a ngarkuara: "Informacion mbi çështjen" dhe RIV (Regjistri i Veprimeve) do të gjeni të gjitha veprimet e kryera në lidhje me kërkesën, si datën e regjistrimit të | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kërkesës në gjykatë, datën e shortit dhe gjyqtarin që i ka rënë për shqyrtim kjo kërkesë.<br>Kërkesa penale që i përket kërkuesit B.T., me objekt: "Rivendosje në afat" është regjistruar në gjykatë në datën (….)/2022 dhe është shortuar në (….)/2022. Kjo çështje i ka rënë për gjykim gjyqtarit (….). Tek "Skeduli i çështjes" do të gjeni planifikimin e seancës gjyqësore, e cila është planifikuar të zhvillohet në datën (….)/09/2022, ora (….). | | |
| 37. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 08.07.2022 | Kërkesë për informacion nga Znj.D.M., në cilësinë e palës paditëse, nëse do të zhvillohet seanca gjyqësore e planifikuar në datën 11.07.2022, datë e cila përkon me festë zyrtare, si dhe deklaron që ka ndërruar adresë dhe kërkon që njoftimi i radhës t'i komunikohet nëpërmjet e-mailit. | Kthim përgjigje me<br>E-mail<br>më datë 08.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.4075 Prot., datë 08.07.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 37, datë 08.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informoj se nga komunikimi me sekretaren që asiston gjyqtaren znj. (….), më bëhet me dije se seanca gjyqësore e datës 11.07.2022 do të shtyhet për shkak të pushimit zyrtar. Ju do të njoftoheni nga ana e gjykatës me flete-thirrje në adresën Tuaj të e-mailit. Gjithashtu, Ju bëj me dije | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | se një kopje e kërkesë Tuaj iu vu në dispozicion gjyqtares, znj. (….). | | |
| 38. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 08.07.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.E.C.., si përfaqësues i palës paditëse Z.D., në lidhje me ecurinë e gjykimit që i përket çështjes civile, me objekt: "*Zgjidhje martese*", çështje të cilën e ka patur për shqyrtim gjyqtarja (….) që është emëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nuk ka ndonjë informacion rreth rishortimit dhe datës së seancës për këtë çështje, duke qenë se palët janë në një situatë të tensionuar. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 08.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.4073 Prot., datë 08.07.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 38, datë 08.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Procesverbalin e çështjes civile me Nr. 21001-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 2. RIV (Regjistri i Veprimeve) të çështjes civile me Nr. 21001-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju informoj se, tek dokumentet e ngarkuara: "Procesverbal" dhe RIV (Regjistri i Veprimeve) do të gjeni të gjitha veprimet e kryera deri në këto momente në lidhje me çështjen e sipërcituar. Ashtu siç Ju jeni në dijeni të faktit, se Gjyqtarja znj. (….) është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Apelit Tiranë. Dosjet gjyqësore civile që ndodhen për shqyrtim pranë kësaj gjyqtare do të rishortohen dhe do t'u shpërndahen me short gjyqtarëve të tjerë që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Për shkak të ngarkesës në punë të gjyqtarëve dhe për shkak të numrit të vogël të organikës në fakt të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është pritur që të emërohen gjyqtarë të rinj, me qëllim rishortimin e çështjeve civile që ka patur në shqyrtim gjyqtarja znj. (….). Gjithashtu, në lidhje me kërkesën Tuaj dhe problematikën që sjell zvarritja e kësaj çështje u vu në dijeni Zv.Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. (….), e cila më komunikoi se do të marrë të gjitha masat e nevojshme për vënien në lëvizje të kësaj çështje. Përsa i përket vijimit të gjykimit, Ju do të njoftoheni nga ana gjyqtarit/es që do marrë në shqyrtim këtë çështje. | | |
| 39. | Shkresë më datë 20.07.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Avokati i Popullit, në lidhje me çështjet gjyqësore që janë | Kthim përgjigje me shkresë më datë 22.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përfunduar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier gjatë vitit 2022 dhe që kanë të bëjnë me: "ndihmën për hyrjen, kalimin, apo qëndrimin e paautorizuar/të kundërligjshëm; me aspekte të barazisë gjinore, ose raste të diskriminimit; vendim gjyqësor lidhur me personat LGBTIQ; si dhe vendim gjyqësor lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga teknologjitë e reja në azil, migracion dhe menaxhimin e kufijve (për Eurodac, SIS dhe VIS)". | | nr.4322 Prot., datë 20.07.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 39, datë 20.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore ***që janë përfunduar*** pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2022 – 22 Korrik 2022, për çështjet gjyqësore, si më poshtë cituar: 1. Për periudhën 01 Janar 2022 – 22 Korrik 2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është dhënë vetëm 01 (një) vendim gjyqësor penal për veprën penale: "*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*" të parashikuar nga Neni 298/3 të Kodit Penal. 2. Bashkangjitur po Ju vëmë në dispozicion: "Vendimin gjyqësor penal Nr. 62-2022-(….), datë (….).(….).2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier". Ky vendim dënimi nuk ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij ka patur ankim dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit Vlorë. 3. Për periudhën 01 Janar 2022 – 22 Korrik 2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier janë dhënë 02 (dy) vendime gjyqësor civile, ku palët paditëse kanë pretenduar se janë diskriminuar nga pala e paditur. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Person i tretë në të dyja këto çështje ka qenë edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bashkangjitur po Ju vëmë në dispozicion: "Vendimin gjyqësor civil Nr.62-2022-(….), datë (….).(….).2022 dhe Vendimin gjyqësor civil Nr. 62-2022-(….), datë (….).(….).2022, të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier". Këto vendime nuk kanë marrë formë të prerë, pasi të dyja vendimet janë apeluar dosjet ndodhen në Gjykatën e Apelit Vlorë. 4. Për periudhën 01 Janar 2022 – 22 Korrik 2022, nga Gjykata 0\e Rrethit Gjyqësor Fier nuk është dhënë asnjë vendim gjyqësor lidhur me personat LGBTIQ. 5. Për periudhën 01 Janar 2022 – 22 Korrik 2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk është dhënë asnjë vendim gjyqësor lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga teknologjitë e reja në azil, migracion dhe menaxhimin e kufijve (për Eurodac, SIS dhe VIS). | | |
| 40. | Shkresë më datë 20.07.2022 | Kërkesë për informacion nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit pranë Këshillit të Ministrave Tiranë në | Kthim përgjigje me shkresë më datë 28.07.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lidhje me personin e autorizuar që ka akses në Modulin e Administratës Publike për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. | | nr.4265 Prot., datë 18.07.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 40, datë 20.07.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Autorizimin e Zv.Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për personin e autorizuar Znj. (….). 2. E-mailin: "Njoftim për trajnim" të datës 28 Dhjetor 2019. Ju informojmë se, personi i autorizuar që ka akses në Modulin e Administratës Publike për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ka qenë dhe do të jetë në vijimësi vetëm Znj.(….), me detyrë: Specialiste IT pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e-mail: (….)@gjykata.gov.al; Institucioni: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, dokumentat me vulë elektronike që kërkohen për shërbimet e ndryshme gjyqësore, në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.158 Prot., datë 25.11.2019. | | |
| 41. | Shkresë më datë 22.09.2022 | Kërkesë për informacion nga Z.L.B., në cilësinë e palës kallëzuese, në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës në shqyrtimin e një kërkese penale, ku | Kthim përgjigje me shkresë më datë 26.09.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5212 Prot., datë 22.09.2022, për dhënie informacioni, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sipas palës kallëzuese ka qenë e padrejtë. | | rregjistruar me numër rendor 41, datë 22.09.2022. Më lejoni t'Ju informoj që, kërkesa Juaj nga pikëpamja formale nuk është në formën e parashikuar nga ligji, pasi nuk është në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e gjykatës. Dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Penale përcaktojnë rregulla të hollësishme për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, personat juridikë dhe shtetasit. Në rast se dëshironi të denonconi një vepër penale, atëherë Ju mund të drejtoheni në çdo komisariat policor, pasi organet hetuese janë policia dhe prokuroria. Mbështetur në nenin 58 pika "f" të Kodit të Procedurës Penale, viktima e veprës penale ka të drejtë *"Të zgjedhë një përfaqësues dhe të përfitojë ndihmë ligjore falas, në kushtet e përcaktuara me ligj"*. Në rast se Ju nuk zotëroni njohuritë e duhura | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | juridike dhe nuk keni mundësi për të marrë një mbrojtës, më lejoni t'Ju sqaroj se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ofron ndihmë juridike falas Av.R.M., me seli të zyrës: "(….)"; me adresë elektronike: (….). Ju informoj se formularët për ndihmë juridike mund t'i gjeni në çdo kohë elektronikisht në faqen zyrtare të: Ministrisë së Drejtësisë - www.drejtesia.gov.al; Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas - www.ndihmajuridike.gov.al; Facebook: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Instagram: Drejtoriandihmësjuridikefalas.Ndihma juridike parësore mund të përfitohet edhe ONLINE: Në platformën www.juristionline.al; si dhe Përmes numrit të telefonit falas 08001010; Gjithashtu, më lejoni t'Ju informoj se gjyqtari është i pavarur në punën e tij dhe se vendimmarrja e gjyqtarit i nënshtrohet kontrollit nga një gjykatë më e lartë. Mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë, sipas legjislacionit në fuqi. Ndodhur në këto kushte, Ju mund të ndiqni rrugën ligjore të ankimit ndaj vendimit të gjykatës. Ju | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.5212 Prot., datë 22.09.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 41, datë 22.09.2022, iu vu në dispozicion ZV/Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (….). | | |
| 42. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 26.09.2022 | Kërkesë për informacion nga Juristja M.B., në lidhje me ecurinë e një kërkese penale të paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nëpërmjet shërbimit postar. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 27.09.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5298 Prot., datë 27.09.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 42, datë 27.09.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: 1. "Informacion dhe skedulin e çështjes me Nr. (….)-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Ju bëj me dije se nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), rezulton se kërkesa penale që i përket palës kërkuese: (….), me objekt: "*Ulje denimi per periudhen 06.07.2021-06.07.2022*" është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjyqësor Fier në datën (….). Kjo çështje është shortuar në datën (….) dhe i ka rënë për shqyrtim gjyqtares, Znj. (….). Seanca gjyqësore për shqyrtimin e kësaj kërkese penale është planifikuar të zhvillohet në datën (….), ora (….), pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtaren (….). | | |
| 43. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 13.09.2022, por lexuar më datë 27.09.2022, për arsye se posta elektronike e Gjykatës sonë ka qenë jashtë funksionit prej sulmit kibernetik që iu bë faqeve dhe platformave zyrtare shqiptare. | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Centre for Legal Empowerment, në lidhje me numrin e punëmarrësve të cilët kanë përfunduar marrëdhëniet e punës për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me punëmarrësin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2017, deri në 28 Shtator 2022. | Kthim përgjigje me E-mail dhe shkresë më datë 28.09.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5299 Prot., datë 27.09.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 43, datë 27.09.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion në lidhje me numrin e punëmarrësve të cilët kanë përfunduar marrëdhëniet e punës për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me punëmarrësin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2017, deri në 28 Shtator 2022, si më poshtë vijon: - Për vitin 2017 kanë përfunduar marrëdhënien e punës me institucionin tonë 02 punëmarrës. - Për vitin 2018 kanë përfunduar marrëdhënien e punës me institucionin tonë 03 | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | punëmarrës; - Për vitin 2019 kanë përfunduar marrëdhënien e punës me institucionin tonë 12 punëmarrës; - Për vitin 2020 kanë përfunduar marrëdhënien e punës me institucionin tonë 05 punëmarrës; - Për vitin 2021 kanë përfunduar marrëdhënien e punës me institucionin tonë 05 punëmarrës; - Për periudhën nga data 01 Janar deri në datën 27.09.2022 kanë përfunduar marrëdhënien e punës me institucionin tonë 04 punëmarrës. 2. Asnjë prej punëmarrësve nuk i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të zgjidhje së kontratës së punës. 3. Për pasojë nuk ekziston asnjë vendim gjyqësor. 4. Nuk ka patur asnjë zgjidhje të kontratës së punës me ndërmjetësim. 5. Askush nga ish punëmarrësit nuk ka kërkuar dëmshpërblim nga ana e gjykatës. *Më lejoni t'Ju sqaroj që marrëdhëniet e punës për të gjithë punëmarrësit e sipërcituar kanë përfunduar për këto arsye: - Për shkak të daljes së punëmarrësit në pension pleqërie; - Për shkak të përfundimit të kontratës së punës me afat të përcaktuar; si dhe - Me kërkesë për dorëheqje me* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *vullnetin e tyre të lirë të punëmarrësit nga puna. - Ndërsa një punëmarrës ka ndërruar jetë.* Gjithashtu, më lejoni t'Ju informoj se posta elektronike e Gjykatës sonë ka qenë jashtë funksionit prej sulmit kibernetik që iu bë faqeve dhe platformave zyrtare shqiptare. Për pasojë, edhe e-maili i dërguar nga ana Juaj është lexuar në datën 27.09.2022. | | |
| 44. | Shkresë më datë 28.09.2022 | Kërkesë për informacion nga Emisioni Investigativ "STOP" në TV KLAN, në lidhje me kthimin e një mjeti të sekuestruar në kuadër të një procedimi penal. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 28.09.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5338 Prot., datë 28.09.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 44, datë 28.09.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, përsa keni kërkuar në lidhje me: "*Kthimin e mjetit të sekuestruar të shtetasit Xh.D.*", Ju sqarojmë se: - Shtetasi Xh.D. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesën penale Nr. (….) Regj.Them., me objekt: "*Kthimin e sendeve të sekuestruara*". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e ka shqyrtuar kërkesën penale të sipërcituar në seancë gjyqësore në prani të palëve dhe me vendimin gjyqësor | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr.(….), datë (….), ka vendosur: "1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Xh.D. 2. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar". Nga komunikimi me K/Sekretaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier na bëhet me dije që dosja gjyqësore është përcjellë me shkresën Nr.404 Regj., datë 05.07.2022, për në Gjykatën e Apelit Vlorë, pasi ndaj vendimit gjyqësor Nr. (….), datë (….)të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është bërë ankim. Dosja aktualisht ndodhet në Gjykatën e Apelit Vlorë. (bashkangjitur po Ju vëmë në dispozicion shkresën përcjellëse të sipërcituar). | | |
| 45. | Shkresë më datë 27.09.2022 | Kërkesë/ankesë për informacion nga Z.V.I. mbi depozitimin e një kërkesë-padie në gjykatë. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 05.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5293 Prot., datë 27.09.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 45, datë 27.09.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se në bazë të vendimit të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të gjitha kërkesat dhe kërkesë-paditë që i drejtohen institucionit tonë depozitohen pranë sportelit të Sekretarisë Regjistruese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe personi përgjegjës për pranimin e tyre është vetëm Znj.F.A., ose mund t'i depozitoni nëpërmjet shërbimit postar. | | |
| 46. | Shkresë më datë 03.10.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, për çështjet që janë shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën Janar 2021 - e në vijim, për veprat penale të parashikuara nga Nenet: 230; 230/a; 230/b; 230/c; 230/ç; 231, 232; 232/a; 232/b; 234; 234/a; 287; 287/a dhe 287/b. Dërgim kopje të vendimeve të | Kthim përgjigje me shkresë më datë 07.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5413 Prot., datë 03.10.2022, për dhënie informacioni/dokumentacioni, rregjistruar me numër rendor 46, datë 03.10.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Vendimet gjyqësore për çështjet e përfunduara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me vendime të pushimit, të dënimit dhe të pafajësisë, për periudhën 01 Janar 2021 – 05 Tetor 2022, për veprat penale të cituara në shkresën Tuaj me nr.2331/6 Prot., datë 27.09.2022" (citohen vendimet). | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pushimit, të dënimit dhe të pafajësisë, brenda datës 01.11.2022. | | | | |
| 47. | Shkresë më datë 05.10.2022 | Kërkesë për informacion nga Z.L.Z., në lidhje me një ankesë që ka ndaj një punonjësi të zyrës së kadastrës. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 06.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5461 Prot., datë 05.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 47, datë 05.10.2022. Më lejoni t'Ju informoj se, kërkesa Juaj depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk është në përputhje me dispozitat procedurale të parashikuara nga nenet 154, 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile. Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç se kur ligji parashikon ndryshe. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Në rast se Ju nuk zotëroni njohuritë e duhura juridike dhe nuk keni mundësi për | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të marrë një mbrojtës, më lejoni t'Ju sqaroj se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ofron ndihmë juridike falas Av.R.M., me seli të zyrës: "(....)"; me adresë elektronike: (.....)@yahoo.com. Gjithashtu, Ju informoj se formularët për ndihmë juridike mund t'i gjeni në çdo kohë elektronikisht në faqen zyrtare të: Ministrisë së Drejtësisë - www.drejtesia.gov.al; Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas - www.ndihmajuridike.gov.al; Facebook: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Instagram: Drejtoriandihmësjuridikefalas.Ndihma juridike parësore mund të përfitohet edhe ONLINE: Në platformën www.juristionline.al; si dhe Përmes numrit të telefonit falas 08001010. | | |
| 48. | Shkresë më datë 05.10.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion ardhur për kompetencë nga KLGJ, në lidhje me ankesën e qytetarit Z.D., për t'i vënë në dispozicion një vendim përgjimi të pretenduar prej tij se është lëshuar nga | Kthim përgjigje me shkresë më datë 06.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj për dhënie informacioni, "Përcjellë për kompetencë" nga Këshilli i Lartë Gjyqësor Tiranë me nr.5457 Prot., datë 05.10.2022, rregjistruar me numër rendor 48, datë 05.10.2022. Pas shqyrtimit të | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. | | kërkesës, Ju informojmë se për shkak të karakterit të tyre sekret, kërkesat penale të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me objekt: “Lejim përgjimi”, apo “Vleftësim vendim përgjimi” shqyrtohen nga gjyqtari i gatshëm në Dhomë të Këshillimit. Asnjë person tjetër i administratës gjyqësore nuk bie në dijeni të këtij vendimi. Gjithashtu, më lejoni t’Ju bëj me dije se në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS) dhe në regjistrat manualë të gjykatës nuk regjistrohen emrat e personave që janë në përgjim, numrat e telefonave për të cilat është vendosur lejimi i përgjimit, apo të dhëna në lidhje me numrin e procedimit penal. Ndodhur në këto kushte, me të dhënat që ju paraqisni në kërkesën Tuaj është e pamundur që të gjendet vendimi i përgjimit i lëshuar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, gjithmonë nëse është lëshuar një vendim i tillë. Duke qenë se Ju keni rënë në dijeni të vendimit të përgjimit, jeni të lutur të paraqisni të dhëna shtesë, si emrin e gjyqtarit që ka dhënë vendimin, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | numrin dhe datën e vendimit, në mënyrë që t'Jua vëmë në dispozicion sipas ligjit. | | |
| 49. | Shkresë më datë 11.10.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga qytetari Z.D., për t'i vënë në dispozicion një vendim përgjimi të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 12.08.2022 nga gjyqtarja e gatshme znj.(….). | Kthim përgjigje me shkresë më datë 12.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5624 Prot., datë 11.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 49, datë 11.10.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se nga verifikimet e kryera në numratorin penal të veçantë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë vendim gjyqësor nga gjyqtarja e gatshme, znj.(….) në datën 12 Gusht 2022 | E plotë | Falas |
| 50. | Shkresë më datë 12.10.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me Personin e Kontaktit (Nëpunës i Mbrojtjes së të Dhënave Personale" të caktuar nga | Kthim përgjigje me shkresë më datë 12.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5652 Prot., datë 12.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 50, datë 12.10.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Vendim Nr.187 Prot., datë 20.04.2021 *"Për emërimin e* | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Titullari për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. | | *specialistit të marrëdhënieve me publikun dhe median"* të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Të dhënat e koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Ju informojmë se, znj.S.F. është personi i autorizuar në zbatim të detyrimit që buron nga ligji nr.119/2014 *"Për të drejtën e Informimit",* e cila njëkohësisht është edhe Person Kontakti (Nëpunës i Mbrojtjes së të Dhënave Personale) për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. | | |
| 51. | Shkresë më datë 18.10.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga shtetasi I paraburgosur z.L.L. në lidhje me ecurinë e çështjes në ngarkim të tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 19.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5827 Prot., datë 18.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 51, datë 18.10.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Vendimin gjyqësor Nr.62-2021-(….), datë (….), që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: "*Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" për personin nën* | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *hetim L.L.*”, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)”. Ju informoj se nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk rezulton të jetë regjistruar asnjë çështje tjetër penale, apo civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në emër të shtetasit L.L, përveç çështjes për të cilën Ju ndodheni në paraburgimin e I.E.V.P – së Fier. Përsa i përket ecurisë së hetimeve për çështjen e sipërcituar, Ju mund t’i drejtoheni Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier | | |
| 52. | Shkresë më datë 18.10.2022 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga qytetari Z.D., për t‘i vënë në dispozicion një vendim përgjimi dhe të gjitha aktet që përmban fashikulli gjyqësor të dhëna nga gjyqtarja e gatshme znj.(….). | Kthim përgjigje me shkresë më datë 19.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.5817 Prot., datë 18.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 52, datë 18.10.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se në bazë të Vendimit Nr.391 Prot., datë 06.07.2022 *“Mbi planifikimin e gjyqtarëve për gjykimin e* | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *kërkesave të palëve gjatë fazës së hetimit paraprak"* për muajin Gusht-2022, të Zv./Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. O.L, rezulton se java e gadishmërisë së gjyqtares znj. (….)për muajin Gusht 2022, ka qenë për periudhën: 08/08/2022 – 14/08/2022. Në zbatim të urdhërit të Zv./Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. O.L. për të verifikuar në numratorin penal të veçantë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 08/08/2022 – 14/08/2022, nuk rezulton të jetë shqyrtuar asnjë kërkesë penale e paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me objekt: *"Lejim përgjimi"*, apo *"Vleftësim vendim përgjimi",* si dhe të jetë dhënë ndonjë vendim gjyqësor me objekt: *"Lejim përgjimi"*, apo *"Vleftësim vendim përgjimi"* nga gjyqtarja e gatshme znj. (….). Bashkëngjitur gjeni:<br>Vendimin Nr.391 Prot., datë 06.07.2022 *"Mbi planifikimin e gjyqtarëve për gjykimin e kërkesave të palëve gjatë fazës së hetimit paraprak"* për muajin Gusht-2022, të Zv./Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. O.L. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 53. | Shkresë më datë 18.10.2022 | Kërkesë/ankesë nga Z.L.B., ku denoncon disa vepra penale, bashkangjitur paraqet akte shkresore. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 21.10.2022 Dhe kthimi i akteve shkresore. | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.5813 Prot., datë 18.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 53, datë 18.10.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës/ankesës, Ju informojmë se pas verifikimit të kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), nuk rezulton të ketë ndonjë çështje civile, apo penale, e cila të jetë duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në mënyrë që të depozitohen aktet shkresore që Ju ia keni bashkangjitur ankesës Tuaj me nr.5813 Prot., datë 18.10.2022. Koordinatori për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e tij në përputhje me nenin 10 të Ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton se gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve, i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve dhe se ndërhyrja në | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | veprimtarinë e gjykatave, ose të gjyqtarëve, passjell përgjegjësi sipas ligjit. Dhënia e drejtësisë duhet të jetë e çliruar nga çdo lloj ndikimi, ndërhyrjeje të subjekteve publike ose private. Në shtetin e së drejtës, mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë. Pavarësia e gjyqësorit mbështetet edhe në nenin 4, Pika 3, nenet 5 dhe 6 të Ligjit nr.98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se: "3. *Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit dhe vendimmarrjes, janë të pavarur dhe të paanshëm". 5. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, administrata gjyqësore respekton pavarësinë e gjyqtarëve, duke shmangur çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor. 6. Çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit*". Në bazë të nenit 277 e vijues të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se ndjekja penale ushtrohet nga prokurori dhe policia gjyqësore, të cilat janë organet e ngarkuara me ligj për kryerjen e veprimeve hetimore. *Në rast se Ju dëshironi të* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *denonconi një vepër penale, organi kompetent për ushtrimin e ndjekjes penale është Policia dhe Prokuroria dhe jo Gjykata.* Sa më sipër, Ju orientojmë që në lidhje me pretendimet Tuaja, apo edhe paraqitja e dokumentave që Ju i çmoni të nevojshme në lidhje me kallëzimin Tuaj, Ju duhet t'i drejtoheni me kërkesë prokurorit si organi kompetent për ushtrimin e ndjekjes penale. Aktet shkresore që Ju ia keni bashkangjitur ankesës Tuaj me nr.5813 Prot., datë 18.10.2022 po Jua kthejmë mbrapsh, në mënyrë që t'ia bashkangjisni kallëzimit Tuaj. Në rast se Ju nuk zotëroni njohuritë e duhura juridike dhe nuk keni mundësi për të marrë një mbrojtës, më lejoni t'Ju sqaroj se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ofron ndihmë juridike falas Av.R.M**,** me seli: "(….)"; me adresë elektronike: (….) dhe Cel. (….). Zgjedhja e një avokati falas nga shteti do t'Ju ndihmojë dhe do t'Ju asistojë për të gjetur zgjidhje ligjore në lidhje me të gjitha problematikat që Ju parashtroni në ankesë. Ju informoj se formularët për ndihmë juridike mund t'i gjeni në çdo kohë elektronikisht në faqen | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zyrtare të: Ministrisë së Drejtësisë - www.drejtesia.gov.al; Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas - www.ndihmajuridike.gov.al; Facebook: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Instagram: Drejtoriandihmësjuridikefalas.Ndihma juridike parësore mund të përfitohet edhe ONLINE: Në platformën www.juristionline.al; si dhe Përmes numrit të telefonit falas 08001010. Ju informojmë se, një kopjo e ankesës Tuaj me nr.5813 Prot., datë 18.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 53, datë 18.10.2022, iu vu në dispozicion ZV/Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (….). | | |
| 54. | Kërkesë për infomacion dërguar me E-mail më datë 19.10.2022 | Kërkesë për informacion nga Av.E.DH, si përfaqësuese e të dënuarit Sh.M., në lidhje me ecurinë e një kërkese penale të depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 19.10.2022 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.5878 Prot., datë 19.10.2022, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 54, datë 19.10.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion dhe skedulin e çështjes me Nr. (….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)”. Ju bëj me dije se nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), rezulton se kërkesa penale që i përket palës kërkuese: Sh.M., me objekt: “*Ulje dënimi për periudhën* (….)” është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën (….)/2022. Kjo çështje është shortuar në datën (….)/2022 dhe i ka rënë për shqyrtim gjyqtares, Znj. (….). Deri në ditën e sotme, nuk është planifikuar seanca gjyqësore për shqyrtimin e kësaj kërkese penale. | | |
